

MARENGLLEN VERLI**RRETH QËNDRIMIT DHE PIKËPAMJEVE TË DIPLOMACISË
AUSTRO-HUNGAREZE NDAJ LIDHJES SHQIPTARE
TË PRIZRENIT DHE YMER PRIZRENIT**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, politika e Austro-Hungarisë, vlerësimet e konsujve të saj dhe Ymer Prizreni, të gjithë këta elementë krijojnë një ndërthurje që meriton të analizohet. Ajo na jep mundësinë për të ndriçuar bindshëm nga një kënd origjinal figurën e njërit prej personaliteteve më të njohur shqiptarë të shekullit XIX, shekullit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i cili u shfaq si meteor në momentin kulmor të saj, në tre vitet e pakrahasueshëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ç'ka do të thotë edhe ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në këtë periudhë.

Kriza lindore e viteve '70 i gjeti shqiptarët të panjohur sa e si duhet në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, me sa duket, edhe në elitën më të lartë të Ballplatzit. A ishte kjo njohje e pakët dhe joreale defekt që vinte nga informacioni i pasaktë i përfaqësuesve të tyre, a ishte pasojë e ndikimit që përcillte pikëpamja zyrtare osmane për shqiptarët, apo ishte rrjedhojë e pamjaftueshmërisë së promovimit që shqiptarët i bënë vetvetes?

Pa dyshim ishin të tria.

Shqiptarët e lënë pas dore në periferi të Perandorisë, të mësuar me anarshi nën një pushtet nominal, të copëtuar administrativisht, të diferencuar dukshëm ekonomikisht e politikisht, të penguar në kultivimin e arsimit dhe kulturës së tyre kombëtare, me një prijës emblematic të madh si Skënderbeu, por gati të harruar prej katër shekujsh, po përpiquej t'i çonte drejt zhdukjes së identitetit një koalicion amorf.

Për turqit, shqiptarët myslimanë ishin arnautët e pabindur, por edhe "të dashur". Ata kishin pasur jo pak rezultat në integrimin e fisnikërisë shqiptare në strukturat qeverisëse të Perandorisë dhe në shfrytëzimin, me ndihmën e saj, të forcës ushtarake shqiptare. Për të tjerët, veçanërisht për fqinjët e tyre të Ballkanit, shqiptarët ishin një racë turko-arnaute, që në

duart e Portës së Lartë kishte qenë “kërbaçi i Xhehnemit” mbi të krishterët. Për sa u përket shqiptarëve të krishterë ata, sipas turqve, nuk llogariteshin shqiptarë. Kjo ishte një gjetje e lumtur për fqinjët e shqiptarëve që kishin nxituar t’i deklarorin grekë, bullgarë, serbë, vllehë ose latinë, por kurrsesi çfarë ishin në të vërtetë.

Nën informacionin tendencioz të servirur nga Porta e Lartë dhe nga monarkitë e vogla ballkanike, mesa duket ishin sfumuar informacionet sporadike objektive të disa udhëtarëve evropianë apo konsujve të aftë e skrupulozë, ku padyshim, ndër më të përgatiturit ishin ata të Austro-Hungarisë, dhe përgjithësisht, ndër kancelaritë e Fuqive të Mëdha kishte paqartësi për kombin shqiptar, synimet, vlerat dhe aftësitë shtetformuese të tij. Përdorimi i togfjalëshit “Nuk ka një kombësi shqiptare, Shqipëria është vetëm një shprehje gjeografike”¹ është vështirë të thuhet nëse ishte më tepër bindje apo cinizëm, edhe pse atij që i atribuohet thënia, Bismarku, ishte aq cinik sa për fuqinë e re të Apenineve, që synonte ta kishte aleate, arrinte të shprehej: “Italisë i është shfaqur oreksi para dhëmbëve”².

Ndërkohë që të tjerët i denigronin, vetë shqiptarët si e ndjenin veten?

Kjo pyetje do të kërkonte një përgjigje shumë të gjatë për të dhënë argumente shumëdimensionale e për të rrëzuar kundërargumentet. LSHP provoi se jo vetëm një grusht ideologësh apo individësh (si për shembull, hartuesit e memorandumit të shkëlqyer në paraqitjen e kauzës shqiptare, që iu dërgua nga Shkodra më 13 qershor 1878 kryeministrit britanik Bikonsfilld³), por masivisht shqiptarët pa dallime krahinore, shtresore, fetare, kulturore, në momentin crucial kur kjo pyetje u shtrua botërisht, në të gjitha format, edhe me armë, e shpallën se ishin shqiptarë.

Ndoshta ende jo të gjithë dinin ta artikulonin këtë, ndoshta ende s’ishin krejtësisht të ndërgjegjësuar se si duhet të vepronin, ndoshta ende nuk kishin fiksuar alfabetin dhe nuk dinin cili ishte flamuri i tyre kombëtar (në një nga betejat e LSHP qe venë re një flamur me luan të

¹ W.N. Medlicott, *Bismarck, Gladstone and the Concert of Europe*, London, 1956, f. 75.

² F. Cognosso, *La questione d’ Oriente dalle origini al Congresso di Berlino*, Torino, 1934, f. 334.

³ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 544; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit* (Përmbledhje dokumentesh), vëll. I, Tiranë, 1984, f. 138-150.

verdhë, ndoshta një simbol i vjetër i Topiajve), ndoshta ndikoheshin tepër nga prijësit e tyre lokalë, por ata gati instiktivisht u bashkuan ndër vedi. Shkaku ishte se masivisht e asimiluan propagandën patriotike laike të ideologëve të tyre të çdo besimi fetar (kujto Pashko Vasën, Sami Frashërin etj. etj.), u diferencuan nga turqit dhe u mbrojtën kundër të gjithëve, për të mos lejuar copëtimin e viseve të veta dhe njëherësh, për të ngritur shtetin kombëtar, qoftë fillimisht si një vilajet ose principatë osmane.

Për tre vjet të LSHP evolucioni që i hatashëm, ishte në fakt revolucion, në çdo pikëpamje. Brenda tre vjetëve fisnikëria shqiptare si shtresë (përfshijto individë të caktuar) e integruar në atë masë në strukturat e Perandorisë sa të dyzohej në qenien dhe ideologjinë e saj midis shqiptarisë dhe osmanisë, u ndie e paaftë për drejtimin e kombit dhe gradualisht u detyrua ta ndajë, në mos t'ia lëshojë atë shtresave të tjera⁴. Të lidhura në interesat e tyre jetike me kombin shqiptar dhe Shqipërinë, të ushqyer me ideologjinë e re, këto shtresa në fund të vitit 1980 dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 1981, edhe pse pa forca të mjaftueshme, (të dobësuar nga tërheqja e të lëkundurve), edhe pse kundër të gjithëve, guxuan të luftonin deri në fund për mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe ngritjen e shtetit kombëtar shqiptar.

Përpjekjet për mbrojtjen e Ulqinit, betejat e Slivovës dhe të Caralevës, edhe pse ushtarakisht të humbura, shënuan fitore për përmbysjen e koncepteve të Europës, për ridimensionimin e vlerave të faktorit shqiptar, si edhe për të fiksuar ekzistencën e çështjes shqiptare në protokollin ndërkombëtar. Ato ngjarje, njëherësh, krijuan pikën e referimit për lëvizjen kombëtare në të ardhmen, duke iu ofruar masave të gjera, shembujt mbresëlënës për programin që duhej realizuar, për mjetet si duhej realizuar ky program dhe për armiqtë që duheshin përballuar.

Gjatë tre vjetëve të LSHP dhe veçanërisht në momentet më të rëndësishme të viteve 1980-1981, roli i Haxhi Ymer Prizrenit ishte shumë i rëndësishëm. Historianët, mbështetur në burime të ndryshme informacioni dokumentar, janë të një mendjeje për këtë. Teologu dhe

⁴ Eqrem bej Vlora, *Kujtime*, vëll. I, Tiranë, 2001, f. 360. Është mbresëlënës fakti që patrioti i njohur Sermedi Said Toptani ndodhej në Gjakovë në kampin e Mehmet Ali Pashës në shtatorin e vitit 1978. Që andej u kthye i plagosur në Tiranë, shërbeu në vise të tjera të Perandorisë dhe nuk shfaqti më aktivitet në Lëvizjen Kombëtare. (Shih në: "Studime historike", nr. 1-2, Tiranë, 2001, f. 161).

mësuesi (në Medresenë e Prizrenit) u shfaq aktiv qysh në vitin 1877 (kur muhaxhirët shqiptarë të dëbuar nga sanxhaku i Nishit prej serbëve, sensibilizuan gjithkënd për rreziqet që priteshin), drejtoi Komitetin e Vetmbrojtjes në sanxhakun e Prizrenit, u zgjodh deputet në Parlamentin Osman dhe njëherësh ishte anëtar i Komitetit të Stambollit. Gjithashtu ishte në krye të Komisionit organizator të Kuvendit, i cili themeloi LShP dhe e zgjodhi anëtar të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes, e njëherësh kryetar të Komitetit Kombëtar të Përgjithshëm të Lidhjes. Në tetor të vitit 1879 Ymer Efendiu u zgjodh kryetar i LShP, duke zëvendësuar sheh Mustafa Tetovën. Nëse për këtë funksion ka ndonjë mendim ndryshe, askush nuk e vë në dyshim se gjatë gjithë kohës Y. Prizreni ishte figura e parë e Lidhjes në Prizren, si edhe faktin se ai u zgjodh dhe mbeti kryetar i qeverisë së përkohshme gjatë gjithë ekzistencës së saj tremujore. Në krye të qeverisë ai drejtoi veprimtarinë politike për vendosjen e administratës shqiptare në vilajetin e Kosovës dhe për mbrojtjen e armatosur kundër ofensivës ndëshkimore osmane. Pas shtypjes së LShP, Ymeri u arratis dhe u vendos në Ulqin, ku edhe ndërroi jetë në mënyrë misterioze⁵.

Dokumentacioni austro-hungarez konsullor i viteve 1887-1881 përmban mjaft të dhëna për LSHP, të cilat dëshmojnë për rolin drejtues të Haxhi Ymer Prizrenit gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së Lidhjes. Veçanërisht të dhëna të shumta për Y. Prizrenin gjenden në raportet dhe dërgesat e tjera shkresore të konsullatës së Prizrenit, si edhe Kryekonsullatës së Shkodrës. Por informacioni dhe vlerësimet e konsujve si për LSHP në përgjithësi, ashtu dhe për Y. Prizrenin, përveç subjektivizmit individual (pa përjashtuar edhe cilësinë dhe vërtetësinë e informacionit të siguruar) mbajnë edhe vulën e politikës austro-hungareze të kohës në rajon. Kjo politikë është mjaft e njohur. Perandoria Habsburge ishte e interesuar për *status-quo*-në në Ballkan, që të shmangej depërtimi i Ruisë aty, të pengohej depërtimi i aleatëve të saj të vegjël. Prandaj përgjithësisht e shikonte veprimtarinë e LSHP kundër interesave të saj. Në Vjenë mund të pranonin ndryshime, vetëm nëse do të kishte pjesë edhe Austro-Hungaria. (Ky ishte thelbi i Marrëveshjes në Raishtad me Rusinë, më 8 korrik 1876, që i rezervonte Bosnjë-Hercegovinën dhe i jepte garancinë se nuk do të krijohet një shtet i madh

⁵ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë 1997; Q. Mataj etj., *Ymer Prizreni, një nga organizatorët dhe udhëheqësit e shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, në: "Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)", vëll. II, Tiranë, 1979, f. 69-74.

sllav në Ballkan. Sipas kësaj marrëveshjeje, Serbia mund të zgjerohej drejt jugut, pra në Kosovë, por mund të krijohej edhe një “Shqipëri autonome”⁶. Vetëm në këtë kontekst Ballplatzi iu qas, për herë të parë, çështjes shqiptare. Sigurimi i pjesës për vete ishte thelbi edhe i Marrëveshjes së fshehtë të Budapestit, në janar të vitit 1877, ku përsëri këmbënguli për Bosnjë-Hercegovinën, po kështu shpjegohet edhe pozicionimi i tij për rishikimin e Traktatit ruso-turk të Shën Stefanit që çoi në organizimin e Kongresit të Berlinit më 13 qershor-13 korrik 1878)⁷.

Austro-Hungaria në periudhën e pleqërisë dhe të humbjes së forcës së dikurshme, nëse nuk do të donte të mburrej vetëm me traditën apo me shkëlqimin e Vjenës dhe luksin e aristokracisë vjeneze, apo me muzikën e Shtrausit, duhet të shtrihej patjetër drejt jugut. Ishte i vetmi drejtim ku mund të merrte diçka nga zotërimet e një shteti krejt të kalbur si Perandoria Osmane, për të zotëruar krahun lindor të Adriatikut dhe për të vënë disi në vend nderin e nëpërkëmbur vitet e fundit.

Në Kongresin e Berlinit, Perandoria Dualiste siguroi të drejtën e okupimit të përkohshëm të Bosnjë-Hercegovinës dhe tani donte qetësi për të gëlltitur prenë. Prandaj çështja shqiptare nuk u ngrit më prej saj dhe nuk u shqyrtua si e tillë në Kongresin e Berlinit. Popullsia dhe tokat shqiptare u përmendën aty vetëm me ndërhyrjen e përfaqësuesve të Portës së Lartë që donin të gjenin argumente për të mos lëshuar territoret e Perandorisë. Austro-Hungaria ngriti vetëm çështjen e “privilegjeve dhe lirive të Mirditës” “të njohura tradicionalisht”, në shërbim të konsolidimit të “protektoratit të kultit”, të cilin ajo (bashkë me Francën) e ushtronte mbi popullsinë katolike të Perandorisë Osmane⁸. Natyrisht autonomia mbi kriteret krahinore dhe madje fetare ishte një mohim i autonomisë së Shqipërisë dhe çështjes shqiptare në tërësi.

Po në këtë kuadër, duke synuar sabotimin e mbrojtjes së Ulqinit nga LSHP, Vjena bënte edhe diferencimin e Vilajetit të Shkodrës nga vilajetet e tjera shqiptare në tetor-nëntor 1880, kur përmes përfaqësuesit

⁶ A. Puto, *vep. e përm.*, f. 103-113.

⁷ *Po aty*, f. 120-138, 185-217.

⁸ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 217; L. Hoxha, *Politika e Austro-Hungarisë ndaj çështjes shqiptare në vitet e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881)*, në vëll. “Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881”, vëll. II, Tiranë 1979, f. 276, etj.

të vet në Shkodër, Lipih, premtonte autonomi vetëm për të⁹. Gjithsesi, në gusht 1880 në komisionin e Rumelisë Lindore, ambasadori austro-hungarez në Stamboll, Kosjek, ishte bashkuar me katër përfaqësuesit përëndimorë të Fuqive të Mëdha (u mënjanua vetëm përfaqësuesi rus) kur Portës së Lartë iu bë e ditur se pesë qeveri nuk kishin kundërshtim nëse ajo e quante me vend t'i bashkonte trevat shqiptare në një vilajet të vetëm. Në fakt, qysh disa muaj më parë më 17 qershor 1878, ambasadori austro-hungarez ishte instruktuar nga eprorët e vet, përkatësisht nga shefi i MPJ të Vjenës, fon Kallej, që të prononcohej pozitivisht në rastin e formimit të një Shqipërie kompakte¹⁰.

Në këtë kohë Porta e Lartë kishte nxjerrë madje një dekret për krijimin e një vilajeti (Vilajetit të Rumelisë), që përfshinte katër vilajetet shqiptare dhe kishte caktuar edhe guvernatorin, por siç duket, nën kundërshtimin e Ruisë, qoftë Porta, qoftë Austro-Hungaria dhe fuqitë e tjera, u tërhoqën¹¹.

Parë në tërësi, politika me dilema e Austro-Hungarisë në këtë periudhë, e mbërthyer pas idesë së status-quo-së, e shqetësuar nga forcimi i tepërt i shqiptarëve nga njëra anë, që mund të sillte probleme në Bosnjë-Hercegovinë, apo nga forcimi i tepërt i fqinjëve të tyre ballkanas, nga ana tjetër, që mund të përfitonin para saj nëse zgjaste një konflikt shqiptaroturk, e pengoi jo pak LSHP. Ndoshta në Vjenë nuk kishin bindjen e britanikëve që me anën e ambasadorit Goshen, të akredituar në Stamboll, "Lëvizjen Shqiptare" e konsideronte "krejt të natyrshme" dhe që arrinte në konkluzion se "trazirat shqiptare" "nuk mund të merreshin thjesht si një manovër e turqve për të mashtruar Evropën e për t'i bërë bisht vullnetit të saj"¹². Ndoshta e kapur pas idesë fikse për të marrë Bosnjë-Hercegovinën gaboi. Firma e hedhur bashkë me Gjermaninë dhe Rusinë në Traktatin e 18 qershorit 1881 në Berlin, pikërisht në përfundim të Krizës Lindore dhe nënshkrimi po atë muaj i Traktatit të aleancës me Serbinë, tregon se në Vjenë, me Gjermaninë pas shpine, ndienin aq siguri

⁹ A. Puto, *vep. e përm.*, f. 33.

¹⁰ *Po aty*. Deklarata e përmendur është vlerësuar më tepër si një edicion apo moment i promovimit të çështjes shqiptare. Shih: *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv* (më tej: *HHSt.A,PA*). Raporte të Kosjekut, datë 21 qershor 1880 dhe Kalleit, datë 17 qershor 1880.

¹¹ Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Dokumentet Osmane (1878-1881)*, Tiranë, 1978; shih edhe K. Frashëri, *vep. e përm.*, f. 355, etj.

¹² A. Puto, *vep. e përm.*, f.35.

sa të mos i trembeshin Ruisë. Afrimi dhe me Italinë në maj 1882, kur u krijua Aleanca Tripalëshe midis Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Italisë, ndoshta i solli Monarkinë Dualiste gjumin e vdekjes, që do të trokiste në derë në vitin 1914.

Pozicioni i tillë i Ballplatzit natyrisht reflektohej në veprimtarinë e nëpunësve të vet konsullorë, çka çoi në armiqësimin e tyre me shqiptarët. Konsulli i Prizrenit, Valldhard, madje në verën e vitit 1880 u detyrua të arratisesh për disa muaj e të kërkonte strehim në Prishtinë e Shkup. Marrëdhëniet e tij të acaruar me shqiptarët dhe drejtpërdrejt me Ymer Prizrenin ndikonin kështu në vlerësimet e tij për LSHP dhe patriotin e shquar. Në parametra të përafërt janë në këtë kohë edhe konsujt e tjerë të Vjenës, ashtu si gjen midis tyre nga ata që në situata specifike, japin vlerësime mjaft objektive. Për shembull konsulli në Tivar, Depolo, në raportet e tij të shtator-tetorit 1880, mbi bazën e vlerësimit të drejtë të informacionit të mbledhur, përshkruan me realizëm rolin e LSHP dhe vendosmërinë masive të shqiptarëve për mbrojtjen e Ulqinit.

Nga raportet e Valldhardit të vitit 1879 mësohet se në tetor të këtij viti Y. Prizreni kishte zëvendësuar sheh Mustafa Tetovën në krye të LSHP dhe në cilësinë e kryetarit merrte pjesë në Kuvendin e Dibrës (20-23 tetor 1880). Sipas konsullit të përgjithshëm në Shkodër, Lipih, në këtë kuvend grupimi i radikalëve, në të cilin rreshtohej edhe Ymer efendiu, përveç mbrojtjes me armë të Ulqinit, kërkoi dhe krijimin e Vilajetit të Shqipërisë dhe të një qeverie të përkohshme shqiptare¹³.

Sidoqoftë, për të krijuar një përfytyrim mbi subjektivizmin e relacioneve konsullore, por edhe mbi evolucionin e tyre, po ndalemi kryesisht në disa dokumente të periudhës 1880-1881. Gjatë këtij harku kohor mungesa e objektivitetit të konsullit të Prizrenit, Valldhard, vërehet veçanërisht në verën e vitit 1880. Në një raport për MPJ në Vjenë, të 9 qershorit, ai shfaqet rob i konceptit se qëndresa shqiptare dhe LSHP dirigjohet nga sulltani¹⁴. Sipas tij, forcat radikale që po fitojnë terren në gjirin e Lidhjes janë vegla të sulltanit, i cili qysh gjatë vitit 1879 paskesh shmangur krerët e “Lidhjes së vjetër” që “për shkak të kulturës së lartë dhe tendencave të tyre humanitare” ishin treguar “të papërshtatshëm për politikën e kalifëve” dhe “po i drejton shqiptarët, në emër të Muhametit,

¹³ *HHSSt.A,PA*. Raporte të Lipihut nga Shkodra, datë 29 tetor, 9 dhe 20 nëntor 1880.

¹⁴ *Po aty*. Raport i Valldhardit nga Prizreni, datë 9 qershor 1880.

nëpërmjet njerëzve të kuranit, të cilëve u ka lënë fuqi të plotë, që të zbatojnë porositë dhe dëshirat e tij”¹⁵.

Në këtë raport Ymer Prizreni paraqitet shprehimisht si “përfaqësuesi i sulltanit” dhe njëri ndër “interpretët fetar të akredituar nga sulltani” të ngarkuar të shfrytëzojnë fanatizmin fetar të shumicës së myslimanëve, për t’i hedhur në veprim sipas synimeve të tij. Madje, sipas konsullit, pikërisht për këtë nëpunësit e lartë të Perandorisë “vezirët, ministrat, valinjtë, mytesarifët etj. kanë pushuar së pasuri ndonjë rëndësi më të madhe se ajo e referentëve të thjeshtë” dhe në Prizren “myderizi Haxhi Omer Efendiu... ka në dorë pushtetin ekzekutiv, kurse Lidhja lokale është vetëm një grup njerëzish “vartës të tij dhe disa besimtarë myslimanë të zgjedhur”. Për konsullin, veprimet e LSHP për të siguruar rezerva drithi, në përgatitje për të përballuar ngjarjet e pritshme janë “sekuestri... pa marrë parasysh të drejtat e pronës”, kurse veprimet për të përgatitur Kuvendin e Jashtëzakonshëm të Dibrës (të 20 tetorit 1880), një tentativë e pasuksesshme e nxitur nga të dërguarit e sulltanit. Por në fund të raportit të 9 qershorit, konsulli thekson se LSHP do të kuvendojë “mbi një ndarje të re politike dhe mbi një administratë autonome të Shqipërisë”, kurse “sulltani i paska rezervuar vetes vetëm të drejtën e emërimit të guvernatorit të përgjithshëm”¹⁶. Kjo pjesë e raportit në fakt rrëzon vlerësimet fillestare të konsullit, sepse jo vetëm nga sa u provua më vonë, por edhe nga të dhënat e momentit, vështirë të besohet një tolerancë e tillë e sulltanit ndaj shqiptarëve, nëse ata do të meritonin vlerësimet që bënte Valdhardi në raport.

Në të njëjtën linjë me raportin e datës 9 qershor 1880, disa ditë më vonë, më 23 qershor, konsulli i Prizrenit Valdhard, i raporton eprorit në Vjenë, (raporti i gjatë shoqërohet dhe nga një ekstrakt) se “Lidhja e këtueshme shqiptare”, nën drejtimin e presidentit të saj Haxhi Omer Prizrenit” po rrit “terrorin kundër administratës turke, në bashkëpunim me nënpresidentin Shuaip Agën dhe nëpërmjet demonstratave masive të vartësve të tij”¹⁷. Ndër shembujt që sillen për ilustrim janë shkarkimi i një nëpunësi dhe dëbimi i tij, marrja nën kontroll e topave para konakut të myteserifit dhe dërgimi me telegraf “në emër të të gjithë Shqipërisë, i një proteste kërcënuese, Konferencës së Ambasadorëve në Berlin”. Sipas

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ *Po aty.* Raport i Valdhardit nga Prizreni, datë 23 qershor 1880.

konsullit “tentativa e re për zgjerimin e Lidhjes ... u argumentua jo vetëm me rrezikun e një invazioni grek dhe malazez, por edhe me thënien e përhapur (dhe këtu Valdhardi ndjehet keq se kanë folur edhe kolegët e tij konsuj) lidhur me marshimin e trupave mbretërore-perandorake deri në Mitrovicë”. Konsulli austrohungarez nënvizon sërish, sikurse në raportin e 9 qershorit, se në Komitetin e Lidhjes mendojnë se një vali, mëkëmbës i sulltanit dhe një haraç i vogël vjetor” do të ishin të vetmet “shprehje të mbisundimit të sulltanit”, kurse administrata “duhet të lihet krejtësisht në duart e shqiptarëve...”. Edhe njëherë në këtë raport, sikurse në atë të 9 qershorit, konsulli na duket kontradiktor në vlerësime, kur përpiqet që veprimtarinë e LSHP dhe të Y. Prizrenit ta barazojë me synimet e sulltanit. Mandej, pasi ka denigruar si “terrorist” Haxhi Omer Prizreni, konsulli nuk ka lënë pa hedhur baltë edhe mbi Shuaip Spahinë apo “Shuaip begun”, “nënpresidentin” dhe “oratorin kryesor të Lidhjes”, të cilin ai e quan një “turk të mbytur në borxhe” që “vetëm nga të dhjetat i detyrohet shtetit 360 mijë piastra”¹⁸. Me sa duket Valdhardi zotëronte të dhëna nga nëpunësit osmanë të tatimeve, por nuk e dinte ose nuk donte ta dinte se borxhet disavjeçare të shumkujt në Kosovë ndaj shtetit osman ishin shprehje e rezistencës dhe kundërshtimit dhe jo thjesht çështje e delikucencës individuale e aq më pak kolektive, siç mund të konsideroheshin ato në Austro-Hungari.

Pa paragjykuar çfarë ka ndikuar më tepër te Valdhardi në vlerësimet që jep për LSHP dhe Ymer Prizrenin, duhet nënvizuar se, pavarësisht nga profesionalizmi i diplomatit austriak, ai nuk pushon së qeni kontradiktor. *Së pari*, vështirë që sulltani në përpjekje për të zotëruar situatën në Perandori (ku ndoshta i duhej të përballonte grupimin që kërkonte kushtetutën) të bënte një lojë aq të rrezikshme në Shqipëri, sa të nxiste një stuhi anarkie, të lëshonte nga dora gjithçka dhe të kënaqej me emërimin e një valiu apo marrjen e një “haraçi të vogël”. Madje këto veprime t’i bënte nën hundën e Fuqive të Mëdha, të cilat status-kuonë e kërkuar në Ballkan e shihnin te stabilizimi i Perandorisë Osmane, kurse këtë proces e konceptonin të arritshëm me rritjen e efikasitetit të administratës dhe përmes reformave të njohura. *Së dyti*, sulltani dhe përgjithësisht Porta e Lartë e kishin të qartë se nën presionin e Fuqive të Mëdha do të lëshonin territore në veri dhe rezistenca e gjatë e shqiptarëve mund të kthehej në bumerang, sikurse edhe ndodhi disa muaj më pas me

¹⁸ *Po aty.*

rastin e dorëzimit të Ulqinit e në vazhdim. Në këto rrethana, nuk kishte pse të nxisnin kuvende të LSHP, si ai i Dibrës, apo masa revolucionare në kuadër të përgatitjeve për qëndresë, siç ishin sekuestrimi i drithërave apo marrja nën kontroll e armatimeve të rënda, refuzimi i rekrutimit, apo ngacmimi i Fuqive të Mëdha me “protesta kërcënuese”.

Por konsullin, mesa duket, e shqetësonte fakti që udhëheqësit e LShP Ymer Prizreni dhe Shuaip Aga ishin të suksesshëm (ndonëse shprehimisht nuk e pranon këtë dhe thotë “tentojnë”) në mobilizimin rreth LSHP të masave shqiptare me argumentin e rrezikut jo vetëm nga “invazioni grek e malazez”, por edhe nga ai i zbritjes së trupave austrohungareze deri në Mitrovicë, për çka kishte pasur akuza edhe nga kolegët e tij të fuqive të tjera. Madje ky lajm i përhapur duhet të ketë qenë tepër shqetësues për Valdhardin, sepse ai rezulton të jetë kompromentuar në përpjekjet për të mbledhur me agjenturën e tij informacione sekrete ushtarake, sikurse pohon vetë në fund të raportit të tij të datës 23 qershor 1880¹⁹.

Informatori i nisur më 19 qershor në Mitrovicë, me udhëzime që të sillte informacione sekrete nga Mitrovica, Prishtina, Shkupi dhe nga “më tutje po të jetë e nevojshme”, që nga të dhëna të tjera indirekte duhet të ketë qenë pikërisht Balto Tarabulluzi, (formalisht përkthyes i konsullatës), duket nuk i ka shpëtuar syrit të LSHP dhe vëmendjes së vetë Ymer Prizrenit. Prandaj dora e tij e ndëshkimit, Ramadan Zaskoku, atentatori i telegrafistit të Maxhar Pashës në gusht të vitit 1878 dhe drejtuesi i trupës së armatosur të Prizrenit, organizoi goditje mbi agjentët austriakë e serbë, ekzekutimin e Baltos dhe njoftimin diplomatik të vetë konsullit (përmes të birit të Shuaip Spahisë), se ishte i padëshirueshëm në Prizren. Në të tillë situatë, cili diplomat i dështuar në misionin e tij të agjentit do të fliste mirë e me objektivitet për ata që i dogjën letrat në dorë. Prandaj ai në të gjithë raportet që harton është i hidhur, prandaj nuk ndjehej i sigurt as nën mbrojtjen e valiut, Osman Pashës, në Prishtinë (ku qe strehuar dhe ku gjithashtu e pranon vetë se vazhdon të ngatërrohet në punët e shqiptarëve, duke këshilluar valiun si të veprojë ndaj LSHP të Prizrenit) dhe i lutej eprorëve (me raportin e datës 28 tetor 1880) ta lejonin të zhvendosej në Shkup²⁰. Madje, në raportin e 28 tetorit shfaqet aq absurd sa të pretendojë se vrasjet e mushirit Mehmet Ali, ferikut

¹⁹ *Po aty.*

²⁰ *Po aty.* Raport i Valdhard nga Prishtina, datë 28 tetor 1880.

Hasan në Novi Pazar dhe Balto Tarabulluzit, janë kryer nga LSHP “me urdhër” ose të paktën “me aprovimin” e sulltanit, me ç’rast nuk le pa përsëritur se “Haxhi Ymer efendiu, kryetari i mëparshëm dhe i sotëm i Ligës, ka qenë dhe është njeriu i besueshëm i sulltanit dhe zbatues besnik i urdhrave të tij”.

Për të justifikuar frikën e shfaqur, që në fakt e ka bazën në veprimtarinë e tij, si edhe kërkesën për t’u larguar nga Prishtina në Shkup, Valdhardi nuk nguron të shpifë se Y. Prizreni përmes R. Zaskosit “kryekomandantit të forcave me anën e të cilave... ushtron pushtetin e vet”, pas vrasjes së Baltos do të likuidonte atë vetë dhe do të bënte “një masakër të madhe mbi të krishterët”²¹.

Koha ka provuar drejtësinë e gjykimeve të LSHP, gjatë ekzistencës së saj, si dhe subjektivizmin dashakeq të konsullit të Prizrenit. Po ashtu ka provuar se gjoja “njeriu i sulltanit” (siç) Ymer Prizreni, ishte nga më të kërkuarit për t’u ndëshkuar pas shtypjes së Lidhjes, ndaj dhe u detyrua të arratiset në Ulqin, ku jetoi rreth 6 vjet, pa i besuar sulltanit dhe ofertave të tij për t’u kthyer me ofiqe.

Subjektivizmin e vrerosur të Valdhardit e dëshmon edhe korrespondenca konsullore e Lipihut nga Shkodra, i cili në 4 dhjetor 1880 relatonte se “autorë anonimë (mesa duket të indinjuar nga roli i Portës në dorëzimin e Ulqinit) i kërkonin me letër Hodo Sokolit, kryetarit të “Komisionit të Miletit” të “ngrinte flamurin kombëtar... dhe të shpallte pavarësinë e Shqipërisë”²². Vetë konsulli i Prizrenit që nga Shkupi, më 31 dhjetor 1880 relatonte se në Kosovë kishte filluar çlirimi i qyteteve dhe i pari që çliruar Prizreni, e pas tij edhe Shkupi e Gjakova²³. Pikërisht në Prizren, në fund të dhjetorit, me nismën e Ymer Prizrenit dhe bashkëpunëtorëve të tij më të afërt të rrymës radikale u riorganizua Komiteti Kombëtar i LSHP, i cili mori vendim çlirimin e krejt Vilajetit të Kosovës dhe thirrjen e mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm të LSHP, për të formuar qeverinë e përkohshme, çka dhe u krye në janar 1881²⁴.

Më 4 mars 1881 Lipihu nga Shkodra njoftonte se sheh Ymeri ishte zgjedhur president i Komitetit të Lidhjes dhe kishte për detyrë të “mbikqyrte administrimin e vendit”. Në po këtë raport njoftohej zgjedhja e Shuaip Spahisë si nënkryetar i qeverisë së përkohshme. Më tej ai

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty* Raport i Lipihut nga Shkodra, datë 4 dhjetor 1880.

²³ *Po aty*. Raport i Valdhardit, datë 31 dhjetor 1880.

²⁴ K. Frashëri, *vep. e përm.*, f. 367.

shtonte se synimi i qeverisë së përkohshme ishte t'i siguronte vendit një rend publik shembullor dhe këtë gjë e kishte arritur “më mirë se në kohën kur administronin funksionarët e Portës”. Konkluzionet e tij Lipihu i ilustronte edhe me shembuj pozitivë në dy raportet e mëvonshme, të datave 12 mars dhe 2 prill 1881²⁵. Gjithashtu ai përmendte punën për mbledhjen dhe miradministrimin e taksave për llogari të Lidhjes, pagesën e rregullt të rrogave për nëpunësit etj. Ç'u mbetej pas kësaj vlerësimeve të Valdhardit të disa muajve më parë? Madje në raportin e 4 marsit Lipihu shprehte mendimin se në rast se sulltani do të kundërshtonte programin autonomist, ai mund të humbiste krejt Shqipërinë, sepse LSHP do të shpallte pavarësinë e Shqipërisë²⁶. Kurse në raportet e datës 8 dhe 12 mars, Lipihu duke analizuar zhvillimin e ngjarjeve në Dibër, informonte se edhe atje sukseset e “Partisë Autonomiste” apo “Partisë së LSH” ishin të rëndësishme²⁷. Ndërkohë konsulli austrohungarez në Tivar, Depolo, më 27 mars 1881, pasi pohonte shtrirjen e autoritetit të qeverisë së përkohshme në 4 ndër 5 sanxhaqet e Vilajetit të Kosovës, shtonte se kryengritja antiosmane kishte pushtuar edhe Dibërën, Tivarin dhe Elbasanin. “Popullsitë e tyre, shkruante ky konsull, janë rreshtuar nën flamurin e Lidhjes së ringjallur”²⁸.

Nuk është vendi këtu të trajtohen informacionet e veprimeve ushtarake për shtypjen e LSHP. Ajo që ka rëndësi për ne janë njoftimet për lëvizjet e fundit të Ymer Prizrenit drejt Ulqinit. Gjithnjë sipas Lipihut, në dy raporte të muajit maj, Ymeri më 30 prill kishte qenë në Gjakovë²⁹. Prej andej ishte tërhequr në Malësinë e Gjakovës. Pastaj kishte kaluar ndoshta në Lumë, në Pukë e në Shkodër dhe në një itinerar të diskutueshëm, rreth datës 26 maj kishte kaluar kufirin turko-malazez.

Dokumenti i fundit që duam të përmendim është raporti i Lipihut i 1 qershorit 1886. Deri në këtë datë Ymer Prizreni ishte gjallë dhe jetonte në Ulqin³⁰. Sipas konsullit austrohungarez, Mustafa Asim pasha e kishte informuar atë (konsullin) se kohët e fundit persona të implikuar ose të interesuar për një lëvizje në Shqipërinë e Mesme, ndër të cilët Gani Beu, vëllai aventurier i Esat Toptanit (që ndoshta kishte kryer punën e

²⁵ *HHSSt.A,PA*. Raporte të Lipihut datë 12 mars dhe 2 prill 1881.

²⁶ *Po aty*. Raport i Lipihut, datë 4 mars 1881.

²⁷ *Po aty*. Raporte të Lipihut, datë 8 dhe 12 mars 1881.

²⁸ *Po aty*. Raport i Depolos, datë 27 mars 1881.

²⁹ *Po aty*. Raporte të Lipihut, datë 20 dhe 28 maj 1881.

³⁰ *Po aty*. Raport i Lipihut, datë 1 qershor 1886.

provokatorit), ku dukej të kishte gisht edhe agjentina greke, kishin dashur të fusin në lojë Ymer Prizrenin. Sipas Mustafa Pashës, konsulli grek në Shkodër, Mitzakis, kishte hyrë në këtë qytet në kontakt me një hoxhë nga Ulqini, njëfarë Salih Efendiu “për ta bindur me dijen e Cetinës” Ymer Prizrenin të merrte pjesë në lëvizjen në fjalë dhe të influenconte pro saj në Dibër, në Tetovë, në Lumë etj.³¹ Lipihu shtonte se mbi komplotistët ishte dhënë goditja dhe “të arrestuarit e krishterë u hodhën në burg”, kurse adjutanti i sulltanit, Ferik Sulejman pasha “i cili tash së fundi është pritur të vijë prej Cetine këtu, - vëren konsulli, - duhet të ketë urdhër në lidhje me komplotin e dështuar...”³².

Ndoshta këtu zë fill vdekja e provokuar apo likuidimi i Ymer Prizrenit. Dhe pavarësisht se kush bashkëpunoi, aprovoi apo kreu detyrën e dorasit, arsyetimi që merr në konsideratë posaçërisht situatën në vitet 1886-1887 të çon në pohimin se i interesuari i parë për zhdukjen e Y. Prizrenit duhet të ketë qenë Porta e Lartë, e ndoshta personalisht sulltani³³. Vërtetimi i këtij arsyetimi do të ishte një argument më shumë për të hedhur poshtë pikëpamjet e pathemelta e denigruese për atdhetarin e shquar, të shfaqura nga diplomatët vjenezë, veçanërisht nga konsulli i Prizrenit, Valdhard.

Gjithsesi opinioni i shqiptarëve është i fiksuar prej kohësh. Ata jo vetëm me intuitë apo informacion folklorik, por veçanërisht mbi bazën e dokumentacionit dhe studimeve shkencore i kanë bërë Ymer Prizrenit vlerësimin e lartë.

³¹ Për veprimtarinë e Greqisë në vitet 80 të shek.XIX shih më hollësisht: *Historia e Shqipërisë*, vëll. II. Tiranë, 1984, f. 300-303.

³² *Po aty*.

³³ Për situatën në vitet 1886-1887 shih: *Po aty*, f. 308-309.

